



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË SH.A

**MBI APLIKIMIN E TAKSËS SË NDËRTESESË NË FATURËN E UJIT**

**NJOFTOJMË TË GJITHË KONSUMATORËT QË AFATI PËR PLOTËSIMIN E FORMULARIT TË VETËDEKLARIMIT ËSHTË DERI NË DATËN 15.09.2019!**

*Ujësjetllës Kanalizime Tiranë vepron në rolin e Agjentit Tatimor në bazë të detyrimeve të përcaktuara në Ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar , VKM nr.132, datë 07.03.2018 dhe VKB nr.157, datë 21.12.2018 dhe marrëveshjes së lidhur mes UKT sh.a dhe Bashkisë Tiranë nr.11188 prot, datë 21.06.2019.*

Baza e llogaritjes së taksës së ndërtesës është vlera e “ndërtesës” shumëzuar me shkallën në përqindje të taksës së miratuar me ligj për kategorinë e ndërtesave për banim që është 0.05%.

Si më poshtë:

**Vlera e ndërtesës x 0,05% = Taksën Vjetore të Ndërtesës** (për ndërtesën/njësinë pronësore që përdoret, shfrytëzohet për banim)

*Shembull:*

*(Apartament me sipërfaqe 70 m<sup>2</sup> x cmim vlerësues 60.000 lek/m<sup>2</sup>) x 0.05% = 2 100 Lek/vit*

*2 100 Lek (Taksa Vjetore): 12 muaj = 175 Lek/muaj*

*Vlera e Taksës mbi Ndërtesën përfshirë në faturën mujore do të jetë 175 lek.*

Ky vetëdeklarim kryhet lehtësisht në të gjitha **PIKAT UKT** si më poshtë:

	<b>PIKA UKT</b>	<b>ADRESA</b>	<b>ORARI</b>
1	Zyrat qendrore të UKT	Rruga e “Kavajës”, godina nr.133	E hënë- premtë 08:00-16:30

2	Pika UKT, Njësia Nr. 1	Rruga "Bardhyl"	E hënë- premte 08:00-18:00 dhe të shtunën 08:00-16:00
3	Pika UKT, Njësia Nr. 2	Rruga "Petro Nini Luarasi", Pallati 10/1, pranë Tregut Elektrik	E hënë- premte 08:00-18:00 dhe të shtunën 08:00-16:00
4	Pika UKT, Drejtoria Rajonale	Rruga e Vjetër Sauk	E hënë- premte 08:00-17:00 dhe të shtunën 08:00-13:00
5	Pika UKT	Rruga "Muhamed Deliu", pranë Freskut	E hënë- premte 08:00-17:00 dhe të shtunën 08:00-13:00
6	Pika UKT	Rruga "Budi"	E hënë- premte 08:00-17:00 dhe të shtunën 08:00-13:00
7	Pika UKT	Rruga "Aleksandër Moisiu", përballë Min. se Kulturës	E hënë- premte 08:00-17:00 dhe të shtunën 08:00-13:00
8	Pika UKT, Njesia Nr.5	Rruga "Llazi Miho", Kombinat, perballe Nj. Administrative nr 6	E hënë- premte 08:00-17:00 dhe të shtunën 08:00-13:00
9	Pika UKT	Bulevardi Zhan D'Ark, përballë Maternitetit të Ri	E hënë- premte 08:00-15:30 dhe të shtunën 08:00-13:00
10	Pika UKT	Rruga "Teodor Keko", pranë Astir	E hënë- premte 08:00-15:30 dhe të shtunën 08:00-13:00
11	Pika UKT	Rruga e Kavajës, pallatet Delijorgji	E hënë- premte 08:00-15:30 dhe të shtunën 08:00-13:00
12	Pika UKT	Kodër Kamëz	E hënë- premte 08:00-15:30 dhe të shtunën 08:00-13:00

Kujdesuni që të keni me vete:

1. **Kopje të ID**
2. **Çertifikatën e Pronësisë me kartelën e pasurisë/ kontrate shitblerje, dhurimi ose shkëmbimi / akt privatizimi apo vetëdeklarimi të ALUIZNI-t, rivlerësim të fundit të pasurisë nëse ka.**
3. **Librezën e ujit apo një faturë UKT**

Gjatë procesit të vetëdeklarimit kryhet edhe përlllogaritja e taksës vjetore për ndërtesën tuaj të banimit.

### **Kategoritë e përjashtuara nga taksa!**

Referuar nenit 22 pika 6 e Ligjit nr.9632, date 30.10.2006 "Per sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, përjashtohen nga taksa mbi ndërtesën kategorite si vijon:

*-pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;*

- ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;
- ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë vetëm pension pleqërie/pension social, kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të paaftë për punë;
- ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;

## **Taksapaguesit!**

Referuar VKM nr.132, datë 07.03.2018 “Taksapagues” subjekt i pagesës së taksës së ndërtesës është: *Çdo individ, person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, pronar apo përdorues i pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave.*

Detyrimin për pagimin e taksës mbi pasurinë e paluajtshme “ndërtesë” e kanë, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente të pronësisë, personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës.

Në kategorinë e taksapaguesve familjarë përfshihen pronarët ose poseduesit e objekteve që shfrytëzohen për banim/strehim, si më poshtë:

1. *Ndërtesa e cila u shërben njerëzve për nevoja themelore banimi, duke përfshirë shtëpitë, apartamentet, banesat dhe ndërtesat e ngjashme;*
2. *Garazhet e mbyllura;*
3. *Bodrumet;*
4. *Çdo ndërtesë tjetër e ngjashme, mbi apo nën tokë, që nuk përdoret apo shfrytëzohet për qëllime të tjera veç atij të banimit.*

## **Vetëdeklarimi!**

Çdo taksapagues duhet të vetëdeklarojë të dhënat për pasurinë e tij të paluajtshme ndërtesë/ njësi pronësore, që ka në pronësi apo në përdorim.

Vetëdeklarimi bëhet pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore apo çdo institucioni të autorizuar nga qeveria apo njësitet e vetëqeverisjes vendore, për të marrë dhe për të përpunuar informacionin e vetëdeklarimit të taksapaguesit, për qëllim të zbatimit të legjislacionit përkatës të taksës mbi pasurinë e paluajtshme.

Në rast se vlera e vetëdeklaruar nga taksapaguesi rezulton e ndryshme nga vlera e llogaritur me çmim e vlerësuar, të përcaktuar në metodologjinë e miratuar me VKM nr.132, datë 07.03.2018, si vlerë e bazës së taksës do të merret vlera më e lartë.

Kur vlerësimi sipas vetdeklarimit dhe vlerës së përcaktuar nga rivlerësimi i pasurisë të regjistruar pranë ZVRPP-ve është i pamundur, çmimi i vlerësuar për vlerësimin e pasurisë së paluajtshme ndërtesë/njësi pronësore do të korrespondojë me çmimin mesatar referues të ndërtesave që përdoren për qëllime banimi

sipas qyteteve, të përcaktuara në aneksin 1 që i bashkëngjitet VKM nr.132, datë 07.03.2018 që është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

### **Proçesi i verifikimit në terren!**

Njësitë e vetëqeverisjes vendore/Agjenti Tatimor në përputhje me kompetencat e kuadrit ligjor në fuqi, kryejnë korrektive në regjistrin e bazës së të dhënave. Korrektimet kryhen bazuar në verifikimet periodike në terren për sipërfaqen e ndërtesës/ njësisë pronësore.

Verifikimi në terren shërben edhe për të regjistruar për herë të parë ndërtesa/njësi pronësore ose nënndarje të saj. Në këtë rast, njësitë e vetëqeverisjes vendore/agjenti tatimor kërkojnë informacion nga burime zyrtare, nëse ka, për sipërfaqen e ndërtesës/njësisë pronësore apo nënndarjen dhe e krahasojnë me verifikimin e kryer. Nëse nuk sigurojnë informacione lidhur me sipërfaqen e ndërtesave të identifikuara, njësitë e vetëqeverisjes vendore bëjnë vetëvlerësimin e ndërtesës/njësisë pronësore mbi sipërfaqen e verifikuar në terren.

Verifikimi në terren për vlerësimin e pasurisë së paluajtshme bëhet, në çdo rast, me urdhër të titullarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore përkatëse/agjentit tatimor, në territorin e së cilës gjendet ndërtesa/njësia pronësore që do të vlerësohet.

### **Sipërfaqja e prezumuar!**

Nëse identifikohet ekzistenca, por nuk arrihet të përcaktohet sipërfaqja e ndërtesës/njësisë pronësore, përdoren vlerat referuese për sipërfaqe, si më poshtë vijojnë:

*a) 100 (njëqind) metër katror sipërfaqe për njësi pronësore, për ndërtesat për banim; (të ndërtuara pas vitit 1993)*

*b) 70 (shtatëdhjetë) metër katror sipërfaqe për njësi pronësore, për ndërtesat për banim, të privatizuara me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, të ndryshuar. (të ndërtuara para vitit 1993)*

**Për çdo paqartësi apo informacion komunikoni me specialistët tanë, ose telefononi në 08004488!**